

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi, me procesmbajtësen Fatmire Sermagaj, në lëndën penale kundër të pandehurit, M. A. nga fshati Zh. K. e Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.499/16, të datës 22.03.2016, të cilin e përfaqësonte prokurori i shtetit, Ismet Ukshini, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar më 27.09.2017, shpalli publikisht, ndërsa më datë 09.10.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M. A. , nga babai U. dhe nëna Z., e lindur B., i lindur më ... në fsh. P. K. e P., me vendbanim në fshatin Zh. K. e Gj., ka të kryer ..., ... punësuar, i martuar , babai ... fëmijëve, i gjendjes së ... ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë, si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datë2015, në objektin e shtëpis së tij në fshatin Zh. Komuna e Gj. i pandehuri me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kunderligjshëm pasuror , nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-Distribuími në Gjilan, ka shfrytëzuar pa autorizim energjin elektrike në atë mënyr që i njëjti ka bërë një degëzim në mur para njësorit elektrik përmes një kablli 3x2.5 mm, me qka ka furnizuar një priz në hapsirën e shkallëve brenda shtëpis dhe me këtë mënyr është furnizuar me energji elektrike pa u regjistruar fare në njësorin elektrik, me qka ka dëmtuar KEDS-in Distribuími në Gjilan, në shumën rreth 31.54 €.

Me çka ka kryer veprën penale, vjedhje shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së,

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuar ligjore si dhe neneve 4, 41, 45,49,50, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurit, i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit M. A., i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditëve, dhe dënimi me gjobë prej 150 €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri detyrohet që të paguajë paushallin gjyqësor ne shumë prej njëzet(20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E dëmtuara KEDS-i, Distribuimi në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 499/16, të datës 22.03.2016, kundër të pandehurit M. A. nga fshati Zh. K. e Gj., për shkak të veprës penale, vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën për shqyrtimin fillestar në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Ismet Ukshini , i pandehuri M. A. si dhe S. M., pwrfaqsesja e tw dwtuarws,KEDS-i, distribumi nw Gjilan.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 27.09.2017 është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranon fajsinë për kryerjen e kësaj vepre.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajsisë, ngase ka konstatuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Gjithashtu gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lart gjyqtari ka vërtetuar gjendjen faktik; se i pandehuri e ka kryer me dashje veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj gjyqtari ka vendosur që të pandehurin M. A. ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale , ngase veprimet e të njëjtit i përmbajn të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është penalisht përgjegjës.

Bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit gjyqtari ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojn në llojin dhe lartësin e dënimit . Me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht si rrethan lehtësuese është marra për bazë pranimi i fajsisë nga ana e të pandehurit , i pandehuri është penduar, është hera e pare që ka kryer vepër, gjendjen e rëndë ekonomike, se i pandehuri është i papunësuar kështu që dënimi me gjobë dhe i pakushtëzuar do të ndikonte gjegjësisht do të përkeqsonte gjendjen ekonomike të të pandehurit dhe mbi këtë bazë te pandehurit i shqipton dënim të kushtëzuar.

Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësis penale dhe rrezikshmërin shoqërore të veprës penale.

Me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit dhe duke marrë për bazë rrethanat e përmendura më lart është dënim i drejtë , në harmoni me peshën e veprës dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, parandalon personat e tjerë në kryerjen e veprave penale dhe shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe respektimin e ligjit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag.1 dhe 2, pika 2.6 dhe 451 parag. 1 KPPRK-së.

E dëmtuara KEDS-i, Distribrimi në Gjilan, konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

***Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 377/16, më 09.10.2017***

***Procesmbajtësja,
Fatmire Sermagjaj, d.v.***

***Gjyqtari
Islam Thaçi, d.v.***

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.